



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA036  
KSC-BC-2020-06/IA037  
KSC-BC-2020-06/IA038  
KSC-BC-2020-06/IA039

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 4 korrik 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**

Luka Mishetiç

**Mbrojtjes së Kadri Veselit:**

Rodni Dikson

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit:**

Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Jakup Krasniçit:**

Venkatesvari Alagenda

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77, 82(4), 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit pas lëshimit nga Trupi Gjykues II të Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 ("Vendimi i Parë për Miratim të Lejes për Apelim"),<sup>1</sup> Vendimit mbi Kërkesën Përmbledhëse të Mbrojtjes për Apelim të Vendimeve mbi Pranimin e Dëshmive si Ekspertë të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874 (F03201 dhe F03203) ("Vendimi i Dytë për Miratimin e Lejes për Apelim"),<sup>2</sup> Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimën e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse ("Vendimi i Tretë për Miratim të Lejes për Apelim"),<sup>3</sup> dhe Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155 ("Vendimi i Katërt për Miratim të Lejes për Apelim"), bashkërisht Vendimet për Miratimin e Lejes për Apelim.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> F03297, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë së Dëshmitarit Ekspert W04875, 1 korrik 2025 (Publik).

<sup>2</sup> F03298, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët Përmbledhëse të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmive si Ekspertë të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874, (F03201 dhe F03203), 1 korrik 2025 (Publik).

<sup>3</sup> F03299, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse, 1 korrik 2025 (Publik).

<sup>4</sup> F03300, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155, 1 korrik 2025, (konfidencial).

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 maj 2025, Trupi Gjykses II lëshoi Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875, <sup>5</sup>Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04826 ("F03201"), <sup>6</sup> dhe Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04874-ës ("F03203").<sup>7</sup>

2. Më 29 maj 2025, Trupi Gjykses II lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse. <sup>8</sup>

3. Më 3 qershor 2025, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi"), dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") dorëzuan Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Pranimin të Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 (F03202)", <sup>9</sup> dhe Kërkesën Përmbledhëse të Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimeve mbi Pranimin e Dëshmise si Ekspertë të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874 (F03201 dhe F03203)".<sup>10</sup>

4. Më 5 qershor 2025, Mbrojtja e zotërinjëve Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi dorëzuan Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së

---

<sup>5</sup> F03202, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875, 27 maj 2025 (Publik).

<sup>6</sup> F03201, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04826-ës, ("F03201"), 27 maj 2025 (Publik). Versioni i korrigjuar u dorëzua më 16 qershor 2025, F03201/COR.

<sup>7</sup> F03203, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04874-ës ("F03203"), 27 maj 2025 (Publik).

<sup>8</sup> F03211, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse, 29 maj 2025 (konfidencial).

<sup>9</sup> F03222, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 (F03202), 3 qershor 2025 (konfidenciale). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2025, F03222/RED.

<sup>10</sup> F03222, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04826 (F03201), 3 qershor 2025 (konfidenciale). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2025, F03222/RED.

Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse (F03211)",<sup>11</sup> dhe Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155.<sup>12</sup>

5. Më 1 korrik 2025, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin e Parë për Leje për Apelim, Vendimin e Dytë për Leje për Apelim, Vendimin e Tretë për Leje për Apelim dhe Vendimin e Katërt për Leje për Apelim ku, ndër të tjera, miratoi pjesërisht kërkesat e Mbrojtjes.<sup>13</sup>

## II. CAKTIMI

6. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë e gjykatësve në këtë moment,

---

<sup>11</sup> F03238, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimën e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse (F03211), 5 qershor 2025 (konfidenciale).

<sup>12</sup> F03239, Kërkesë e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155, 5 qershor 2025 (konfidenciale).

<sup>13</sup> F03297, Vendimi i Parë për Leje për Apelim, para. 49; Vendimi i Dytë për Leje për Apelim, f. 17; Vendimi i Tretë për Leje për Apelim, para. 28 Vendimi i Katërt për Miratimin e Lejes për Apel, para. 57.

**KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:**

**Gjykatëse Mishelë Pikar**

**Gjykatës Kai Ambos**

**Gjykatëse Nina Jorgensen**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me katër apele më vete në lidhje me Vendimet për Leje Për Apelim dhe aspekte që kanë të bëjnë me to.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**

**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 4 korrik 2025

Në Hagë,

Holandë.